

**VENDIM**  
**Nr. 865, datë 24.12.2019**

**PËR MËNYRËN E KRYERJES SË PROCESIT TË AKREDITIMIT TË  
INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR E PËRCAKTIMIN E  
TARIFAVE DHE AFATEVE KOHORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, përjashtuar laboratorët mjekësorë, duhet të plotësojnë standardet bazë për akreditim.

2. Procesi i akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor realizohet nga këto struktura përgjegjëse:

- a) ministri përgjegjës për shëndetësinë (në vijim, ministri);
- b) institucioni përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor;
- c) bordi i akreditimit.

3. Pas licencimit të veprimtarisë përkatëse, të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen verifikimit nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetësisë të përmbushjes së standardeve bazë për akreditim.

4. Grupet e inspektimit verifikojnë pranë institucioneve të kujdesit shëndetësor përmbushjen e standardeve bazë të akreditimit, të miratuara nga ministri dhe hartojnë raportin përkatës me institucionet që kanë përmbushur ose jo standardet bazë të akreditimit. Ky raport dërgohet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

5. Institucioni përgjegjës për akreditimin, pas marrjes së raportit, njofton institucionin e kujdesit shëndetësor që ka plotësuar standardet bazë të akreditimit dhe e fton të vijojnë procesin e akreditimit.

6. Ministri, pas marrjes së raportit për institucionet e kujdesit shëndetësor publik, që nuk përmbushin standardet bazë të akreditimit, vendos, me urdhër, masat përkatëse për këtë institucion.

7. Ministri, pas marrjes së raportit për institucionet e kujdesit shëndetësor, jopublike, që nuk përmbushin standardet bazë të akreditimit, vendos pezullimin e licencës për një periudhë 30-ditore (tridhjetëditore). Nëse edhe pas kësaj periudhe institucioni i kujdesit shëndetësor nuk i ka përmbushur standardet bazë të akreditimit, atëherë ministri vendos revokimin e licencës.

8. Vendimi i ministrit për pezullimin e shfuqizimin e licencës së institucionit të kujdesit shëndetësor jopublik publikohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve dhe i përcillet për njoftim Qendrës Kombëtare të Biznesit.

9. Institucioni i kujdesit shëndetësor, që ka plotësuar standardet bazë të akreditimit, pas ftesës së marrë nga institucioni përgjegjës për akreditim, mund të vijojë procesin e akreditimit sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim.

10. Institucioni përgjegjës për akreditimin i jep institucionit të kujdesit shëndetësor standardet optimale për akreditim, formularët që duhet të plotësohen, si dhe dokumentacionin bashkëshoqërues ndihmës për vetëvlerësim.

11. Institucioni i kujdesit shëndetësor, pas pajisjes nga institucioni përgjegjës për akreditimin me dokumentacionin e sipërcituar, merr masat për kryerjen e vetëvlerësimit. Institucioni i kujdesit shëndetësor vlerëson vetveten përkundrejt standardeve të akreditimit dhe harton

raportin/et e vetëvlerësimit, të cilat dorëzohen, brenda dy muajve pas marrjes së ftesës, pranë institucionit përgjegjës, si dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm për akreditim.

12. Në përfundim të vetëvlerësimit, institucioni i kujdesit shëndetësor dorëzon raportin e fundit të vetëvlerësimit dhe bën kërkesën për vlerësim të jashtëm nga ekspertët e përcaktuar nga institucioni përgjegjës për akreditim.

13. Pas dorëzimit të raportit të vetëvlerësimit, institucioni përgjegjës për akreditim, dakordëson me institucionin e kujdesit shëndetësor datën e vlerësimit të jashtëm brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor).

14. Kohëzgjatja nga momenti i marrjes së ftesës për akreditim deri në vizitën përfundimtare të ekspertëve të vlerësimit të jashtëm nuk duhet të kalojë periudhën 6-mujore (gjashtëmujore).

15. Institucioni përgjegjës për akreditimin harton programin e vlerësimit të jashtëm akreditues dhe njofton paraprakisht titullarin e institucionit shëndetësor për programin që do të ndjekë ekipi i vlerësuesve të jashtëm dhe përbërjen e tij. Njëri nga anëtarët e ekipit zgjidhet si drejtues i ekipit. Ekspertët e përzgjedhur për të kryer vlerësimin e jashtëm trajnohen nga institucioni përgjegjës për akreditim sipas një programi të miratuar nga bordi i akreditimit dhe plotësojnë një deklaratë që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Vizita e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm akreditues kryhet në datat e paracaktuara nga institucioni përgjegjës për akreditimin dhe institucioni i kujdesit shëndetësor. Institucioni duhet t'i ofrojë ekipit kushte optimale pune, pavarësi, mbrojtje dhe mbështetje nga çdo ndikim.

17. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm harton brenda 2 (dy) javësh draftraportin e vlerësimit lidhur me përmbushjen me standardet dhe ia paraqet institucionit të kujdesit shëndetësor dhe institucionit të vetëvlerësuar për komente e sugjerime të mundshme.

18. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm mund të marrë parasysh ose jo vërejtjet e institucionit të kujdesit shëndetësor dhe, brenda një jave, dorëzon raportin final të vlerësimit të firmosur nga të gjithë anëtarët e ekipit pranë institucionit përgjegjës për akreditimin, i cili i jep një kopje të këtij raporti institucionit të kujdesit shëndetësor.

19. Pas marrjes në dorëzim të raportit final nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, institucioni përgjegjës për akreditimin përgatit për mbledhjen e ardhshme të bordit të akreditimit dosjen e plotë të akreditimit.

20. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm paguhen me një tarifë ditore prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, të cilat përballohen nga institucioni përgjegjës për akreditimin.

21. Ministri vendos për akreditimin ose jo të institucionit të kujdesit shëndetësor, pasi shqyrton rekomandimet e bordit të akreditimit dhe vendos të miratojë atë ose ta kthejë për rivlerësim nëse e gjykon të arsyeshme brenda një afati 30-ditorë (tridhjetëditor).

22. Bordi i akreditimit të institucioneve shëndetësore ngrihet pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:

- a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) dy përfaqësues të institucionit përgjegjës për akreditimin;
- c) një profesionist shëndetësor me gradë shkencore ose titull akademik, i përzgjedhur nga ministri;
- ç) një përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

23. Emërimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe i anëtarëve të bordit të akreditimit bëhen me urdhër të ministrit.

24. Bordi i akreditimit mbledhet jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit. Anëtari i këtij bordi, i cili mungon pa arsye në 1/3 e mbledhjeve, zëvendësohet.

25. Anëtarët e bordit të akreditimit duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë konfliktin e interesit.

26. Mbledhja e bordit të akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 3 (tre) anëtarë.

27. Bordi i akreditimit miraton rregulloren e funksionimit të tij të brendshëm.

28. Bordi i akreditimit mbështetet nga sekretariati teknik, i përbërë nga nëpunës të institucionit përgjegjës për akreditim, të caktuar nga titullari.

29. Bordi i akreditimit ka të drejtë që të thërrasë specialistë të fushave shëndetësore, rast pas rasti, në varësi të profilit të institucionit shëndetësor që do të akreditohet.

30. Bordi i akreditimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) shqyrton raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të cilësisë për akreditim të parë dhe periodik;

b) harton e dërgon rekomandimin për ministrin, bazuar në raportin e vlerësuesve të jashtëm;

c) kërkon të dhëna e dokumente të mëtejshme nga institucioni përgjegjës për akreditimin dhe institucioni i kujdesit shëndetësor që është në vlerësim;

ç) dëgjon e shqyrton ankesat e mundshme të institucioneve që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm dhe vendos për to;

d) miraton kriteret specifike të përzgjedhjes së ekspertëve të vlerësimit;

dh) miraton listën vjetore të ekspertëve të përzgjedhur si vlerësues;

e) miraton programin e trajnimit të ekspertëve të vlerësimit.

31. Anëtarët e bordit të akreditimit shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve/komiteteve/komisioneve.

32. Bordi i akreditimit merr në shqyrtim dokumentacionin përkatës të dosjes të sipërpërmendur dhe, me shumicë votash, rekomandon:

a) akreditimin e plotë për 5 (pesë) vjet kur realizimi i standardeve optimale është >85%;

b) akreditimin e pjesshëm 1–3 (një deri në tre) vjet kur realizimi i standardeve optimale është >70%;

c) mosdhënien e akreditimit kur realizimi i standardeve optimale është <70%.

33. Institucioni përgjegjës për akreditimin i dërgon rekomandimin e bordit të akreditimit ministrit, i cili, bazuar në rekomandimin e bordit të akreditimit, merr vendimin për akreditimin ose jo të institucionit të kujdesit shëndetësor, brenda një afati 30-ditor (tridhjetëditor).

34. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatë brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

35. Institucioni përgjegjës për akreditimin bën publike certifikatën dhe emblemën e akreditimit, të cilat institucioni i kujdesit shëndetësor ka të drejtë t'i afishojë në një vend të dukshëm për publikun.

36. Format i certifikatës së akreditimit dhe i emblemës miratohen me urdhër të ministrit.

37. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë shpall publikisht listën e institucioneve të akredituara dhe të atyre që nuk kanë përmbushur standardet bazë për akreditim.

38. Tarifat për kryerjen e gjithë procesit të akreditimit janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit derdhen 50 (pesëdhjetë) % në buxhetin e institucionit përgjegjës për akreditim dhe 50 (pesëdhjetë) % në buxhetin e shtetit. Të ardhurat dytësore të realizuara nga aplikimi i tarifave të procesit të akreditimit, që derdhen për llogari të institucionit përgjegjës për akreditim, klasifikohen si të ardhura jashtë limitit (kapitulli VI). Kriteret dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

39. Vendimi nr. 315 datë 23.3.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe për mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore", i ndryshuar, shfuqizohet.

40. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

## ANEKSI 1

### TARIFAT PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Tarifat për realizimin e procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor janë, si më poshtë vijon:

a) akreditim i strukturave shëndetësore universitare	400 000 lekë;
b) akreditim i spitaleve private	400 000 lekë;
c) akreditimi i spitaleve ditore	150 000 lekë
ç) akreditim i spitaleve rajonale publike	200 000 lekë;
d) akreditim i spitaleve bashkiake publike	100 000 lekë;
dh) akreditim i qendrave shëndetësore	60 000 lekë;
e) akreditim i kabineteve mjekësore	50 000 lekë;
ë) qendër mjekësore	200 000 lekë;
f) akreditim i shërbimeve shëndetësore brenda spitalit	100 000 lekë
g) akreditim i klinikave stomatologjike	200 000 lekë;
gj) akreditim i kabineteve stomatologjike	50 000 lekë;
h) akreditim i farmacive	50 000 lekë;